

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	SHBA fokus te kartelet e drogës, zv/ndihmës Sekretari i Shtetit: Po punojmë për shkatërruar organizatat kriminale. Kosovë- Serbi të shmangin provokimet
ADRESA	https://dosja.al/draft/shba-vijon-luften-kunder-karteleve-te-s-zv-ndihmes-sekretari-i-sh-teti-i514287
BURIMI	dosja.al
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	15 shtator 2026, 15:38:06 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	15 shtator 2026, 15:30:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	512808a9743e46e117302ac6fc923cd1a865a88a70420341cf5490c857e19b4d
TEKSTI	16988197bf754b64af2e210fc8e3ff22c8e403e231385d0b136411a6d01141f0
PAMJA	0efbb8bdba1cab75f18bf93712a1535c3e40afc34c557febc93a6e180824928e

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	a28562e4cfdac699678ac632cb3b06117ecf9c12212c5a60fb43fdad8e473b00
E MËPARSHMJA	cd8e20f70148074bf3e65c47286d948f421095e29253a3567cca80183e35e6e4
RRËNJA MERKLE	4768c0741a99d31c0c1ea2cb7e5bc9124f7af2f5dea963bef58ba2da55aae
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahase hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

https://scan.stamles.eu/verify/a28562e4cfdac699678ac632cb3b06117ecf9c12212c5a60fb43fdad8e473b00

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



LIVE UPDATES

1 ORE ME PARE

SHBA fokus te kartelet e drogës, zv/ndihmës Sekretari i Shtetit: Po punojmë për shkatërruar organizatat kriminale. Kosovë- Serbi të shmangin provokimet

3 ORE ME PARE

Pagat e magistratëve/ Seanca dëgjimore me institucionet e drejtësisë në komisionin e Ligjeve, KLP e GJL kundër formulës së PS: Rritje minimale

7 ORE ME PARE

Rekursi i Veliajt në Gjykatën e Lartë/ GJL lë fuqi vendimin e GJKKO-së, Erion Veliaj mbetet në burg

23 ORE ME PARE

107 ditë revoltë, qytetarët nuk e ndalin rezistencën, oshëtin bulevardi: Shqipëria kërkon revolucion

LIVE UPDATES

SHBA fokus te kartelet e drogës, zv/ndihmës Sekretari i Shtetit: Po punojmë për shkatërruar organizatat kriminale. Kosovë- Serbi të shmangin provokimet

• Zëvendës ndihmës Sekretari amerikan i Shtetit, Daniel Lawton, ka dëshmuar para Nënkomitetit për Evropën të Komitetit të Punëve të Jashtme të Dhomës së Përfaqësuesve, për të prezantuar politikën e administratës së Donald Trump për Ballkanin Perëndimor. • Në fjalimin e tij zyrtar, zyrtari i lartë amerikan shpalosi strategjinë e Uashingtonit për rajonin, duke u fokusuar në sigurinë dhe luftën kundër krimit të organizuar. • Duke përmendur vendet e rajonit, ai tha se po punojnë me Shqipërinë për të goditur organizatat kriminale transnacionale dhe për të zgjeruar qasjen e kompanive amerikane në treg. • Lawton u ndal edhe te Kosova, Serbia dhe Bosnje-Hercegovina, duke nënvizuar rëndësinë e stabilitetit rajonal dhe të bashkëpunimit në fushën e sigurisë. • Sa i përket Kosovës dhe Serbisë, ai tha se normalizimi i marrëdhënieve mbetet thelbësor për paqen në rajon dhe u bëri thirrje të dyja palëve të shmangin provokimet dhe të rikthehen në dialogun e drejtpërdrejtë. • Ai theksoi ndër të tjera se strategjia e re e Uashingtonit mbështetet mbi tri shtylla kryesore: ruajtja e stabilitetit, avancimi i interesave ekonomike të biznesit amerikan dhe lufta pa kompromis ndaj kërcënimeve të sigurisë.

4 artikuj për këtë temë.

2 ORE ME PARE

"KFOR me rëndësi për stabilitetin në Ballkan"/ Daniel Lawton: Administrata e Trump po angazhohet në nivele të larta! Do donim të shihnim më shumë progres në...



Daniel Lawton

editoriale

Irena Beqiraj

Fashizmi nuk duhet
kërkuar tek revolta e
protestuesve por në Kuvend!

Meri Lika

Plaçkaxhiu

Në vëmendje

AKTUALITET 15 SHTATOR 2026, 13:44

Skema se si IUTE zbras
fitimin nga Shqipëria, që ju
merr konsumatorëve me
interesa mbi 30%!

TIRANË- Zëvendësndihmës Sekretari amerikan i Shtetit, Daniel Lawton, deklaroi se bashkëpunimi me Ballkanin Perëndimor është jetik për SHBA. Duke folur përpara Nënkomitetit për Evropën të Komitetit të Punëve të Jashtme në

Dhomën e Përfaqësuesve, Lawton tha se KFOR ka një mbështetje të jashtëzakonshme për stabilitet në Ballkan. Lawton theksoi ndër të tjera se SHBA dëshiron të shohë më shumë progres në marrëdhënies mes Kosovës dhe Serbisë.

"Administrata e Trump po angazhohet me nivele më të larta, SHBA po përpaket të bëhet partner i duhur duke promovuar zgjidhje amerikane si në mbrojtje, energji dhe ekonomi edhe për të ndërtuar edhe një marrëdhënie me Beogradin... Mendoj se forca e KFOR është e jashtëzakonshme për stabilitet në Ballkan. Ne vazhdojmë të optimizojmë kontributin amerikan në misioni paqeruajtës. Do donim të shihnim më shumë progres në marrëdhënies mes Kosovës dhe Serbisë", tha ai./Dosja.al

2 ORE ME PARE

Daniel Lawton: Po punojmë për të goditur në Shqipëri organizatat kriminale transnacionale



Daniel Lawton

SHBA- Zëvendësndihmës Sekretari amerikan i Shtetit, Daniel Lawton, ka deklaruar se SHBA, në bashkëpunim me autoritetet shqiptare po punojnë për të goditur organizatat kriminale transnacionale shqiptare. Duke folur përpara Nënkomitetit për Evropën të Komitetit të Punëve të Jashtme në Dhomën e Përfaqësuesve, Lawton ka shpalosur zyrtarisht strategjinë e administratës së Presidentit amerikan Donald Trump për Ballkanin Perëndimor.

"Ne po punojmë ngushtë me aleatin tonë të NATO-s, Shqipërinë, për të goditur organizatat kriminale transnacionale dhe për të zgjeruar qasjen e kompanive amerikane në treg. Një hua e finalizuar së fundmi në kuadër të Financimit të Huaj Ushtarak do ta ndihmojë Shqipërinë të përmbushë angazhimet e NATO-s për shpenzimet e mbrojtjes dhe të rrisë blerjen e pajisjeve të prodhuara në SHBA", u shpreh Zëvendësndihmës Sekretari i Shtetit.

Ai bëri me dije se strategjia e re e Uashingtonit mbështetet mbi tri shtylla kryesore: ruajtja e stabilitetit, avancimi i interesave ekonomike të biznesit amerikan dhe lufta pa kompromis ndaj kërcënimeve të sigurisë.

"Shtylla e tretë është bashkëpunimi me partnerët për t'iu kundërvënë kërcënimeve, përfshirë organizatat kriminale transnacionale ballkanike që bashkëpunojnë drejtpërdrejt me kartelet e Hemisferës Perëndimore që kërcënojnë Shtetet e Bashkuara", nënvizoi ai.

Më tej, diplomati amerikan nënvizoi përkushtimin ndaj sovranitetit të Bosnje-Hercegovinës dhe pavarësisë së Kosovës, ndërsa shprehu shqetësim për vonesat institucionale në Prishtinë dhe veprimet e tepruara policore ndaj popullsisë serbe./Dosja.al

2 ORE ME PARE

"Kosova dhe Serbia të shmangin provokimet"/ Zv/Ndihmës Sekretari i Shtetit, Daniel Lawton: Angazhimi me Ballkanin perëndimor matet me rezultate të dukshme



POLITIKE 15 SHTATOR 2026, 13:00

"Paga bruto e një magjistari"/ Gafat e njëpasnjëshme të deputetes socialiste: Mos e bëni qaq të madhe, është laps

ART&ARGËTIM 15 SHTATOR 2026, 10:17

Matthew Rhys bën histori në Emmy Awards, bëhet aktori i parë që fiton dy çmime kryesore në një natë

më të klikuarat



Pse bën foto? Rama kap të riun nga qafa dhe ia dorëzon policisë, çfarë ndodhi në Aeroportin e Napolit? (VIDEO)

Vrasja e Franc Konomit, flasin familjarët e tij/ Gruaja: Hotelin ia mori vëllai dhe ia shiti. I biri: Kanë dashur të më vrasin edhe mua dy herë

Dhunuan me grusht qytetarin gjatë arrestimit, Taulant Balla i del në mbrojtje Policisë: Bën detyrën e tyre

Vitin e ardhshëm zgjedhjet lokale/ Qeveria 'hap thesin' për pensionistët: Nga 1 janari do dyfishohet bonusi për të gjitha kategoritë

insights

Ola Xama

Republika e 1 euroshit ku Rama zgjedh kush bëhet biznesmen

Idriz Konjari

Sa gati është biznesi shqiptar për tu përshtatur me tregun e BE-së?

Bledian Koka

Pse Erion Veliaj e "shkarkoi" sot Edi Ramen?

Fjola Graçi

REPUBLIKA E TRUPROJAVE/ Nga tokat te klubet VIP: Rrjoll, Zvërnec, Sarandë e Ksamil



Daniel J. Lawton

SHBA- Daniel J. Lawton, zv.ndihmës sekretar i Shtetit në Byronë për Çështjet Evropiane dhe Euroaziatike, duke folur në një seancë dëgjimore të Komitetit për Evropën të Komitetit për Punë të Jashtme të Dhomës së Përfaqësuesve të SHBA-së, me temë "Politika e SHBA-së dhe sfidat e sigurisë rajonale në Ballkanin Perëndimor", u ndal te marrëdhëniet Kosovë-Serbi.

Ai i bëri thirrje Kosovës dhe Serbisë që të shmangin provokimet dhe të përqendrohen në rezultate konkrete në kuadër të angazhimit për stabilitetin e Ballkanit Perëndimor. Lawton tha se Uashingtoni është i gatshëm të bashkëpunojë me udhëheqjen e re të Kosovës, ndërsa theksoi se Prishtina duhet të përmbyllë sa më shpejt proceset institucionale.

Sipas zyrtarit amerikan, Kosova dhe Serbia duhet të tregojnë përmbytje dhe të shmangin çdo veprim që mund të rrisë tensionet. Ai foli gjithashtu për ndikimin e Rusisë dhe Kinës në rajon, duke vënë në dukje se një pjesë e madhe e investimeve kineze në Ballkanin Perëndimor është përqendruar në Serbi.

"Jemi të gatshëm të bashkëpunojmë me udhëheqjen e re dhe kemi nxitur udhëheqësit e Kosovës të zgjedhin. Angazhimi me Ballkanin perëndimor matet me rezultate të dukshme. Kosova dhe Serbia të shmangin provokimet. Kemi folur për ndikimin rus në Shqipëri, por pjesa më e madhe e investimeve kineze shkojnë në Serbi. Ne kemi një agjendë bashkëpunimi me Kosovën. Bashkëpunimi është penguar nga zgjedhjet atje. Kosova duhet ta zgjedhë sa më parë presidentin", tha Daniel J. Lawton./Dosja.al

4 ORE ME PARE

SHBA fokus te kartelet e drogës, zv/ndihmës Sekretari i Shtetit: Organizatat kriminale kërcënojnë edhe SHBA. Ngërçi politik në Kosovë problem



DASH

SHBA- Administrata amerikane e Donald Trump vijon ta ketë në fokus luftën kundër karteleve të drogës dhe organizatave kriminale transnacionale. Zëvendës Ndihmës Sekretari i Shtetit, Daniel Lawton, do të paraqesë sot përpara Nënkomitetit për Evropën në Komitetin e Punëve të Jashtme të Dhomës së Përfaqësuesve në SHBA të dhënat mbi situatën në Ballkanin Perëndimor.

Në raportin e dorëzuar në Komitet, Lawton shpalos strategjinë e Uashingtonit për rajonin, duke vënë theksin te siguria, interesat ekonomike dhe lufta kundër krimit të organizuar. Ndërsa për vendet e tjera të rajonit evidentohen problematika si ngecja e dialogut Serbi-Kosovë, situata në Bosnje dhe Hercegovinë dhe forcimi i bashkëpunimit me Maqedoninë e Veriut, për Shqipërinë në fokus janë organizatat kriminale transnacionale dhe lidhjet e tyre me kartelet e drogës në Amerikën Latine. Sipas Lawton, këto rrjete kriminale përbëjnë një kërcënim edhe për Shtetet e Bashkuara.

"Politika e SHBA-së mbështetet në tre shtylla. E para është ruajtja e stabilitetit, një parakusht për të gjitha objektivat tona.

Së dyti, ne po çojmë përpara interesat ekonomike dhe komerciale të SHBA-së përmes rritjes së udhëhequr nga sektori privat dhe klimave të investimeve që mirëpresin biznesin amerikan. Së treti, ne po punojmë me partnerët tanë për të luftuar kërcënimet, përfshirë ato nga organizatat kriminale transnacionale të Ballkanit që bashkëpunojnë drejtpërdrejt me kartelat e Hemisferës Perëndimore që kërcënojnë Shtetet e Bashkuara”, thekson Lawton.

Duke u ndalur konkretisht te Shqipëria, zyrtari i lartë amerikan thotë se Uashingtoni po bashkëpunon ngushtë me Tiranën për goditjen e organizatave kriminale transnacionale.

“Ne po punojmë ngushtë me aleatin tonë të NATO-s, Shqipërinë, për të shkatërruar organizatat kriminale transnacionale dhe për të zgjeruar qasjen në treg për kompanitë amerikane. Një kredi e finalizuar së fundmi për Financimin Ushtarak të Jashtëm do të ndihmojë Shqipërinë të përbushë angazhimet e saj për shpenzimet e mbrojtjes të NATO-s dhe të rrisë shitjen e pajisjeve të prodhuara nga SHBA”, shprehet Lawton.

Sa i përket Kosovës, SHBA ka përsëritur qëndrimin në mbështetje të pavarësisë dhe integritetit territorial të vendit. Megjithatë, në dokument janë evidentuar edhe shqetësime për zhvillimet e brendshme politike dhe institucionale. Lawton ka përmendur zgjedhjet e përsëritura, qeveritë në detyrë për periudha të gjata dhe vonesat në formimin e institucioneve si faktorë që kanë penguar agjendën e përbashkët.

Në vëmendje është edhe çështja e komunitetit serb. SHBA ka shprehur shqetësim për atë që e cilëson si shqyrtim të tepruar ligjor dhe policor ndaj popullatës serbe në Kosovë, duke kërkuar të drejta të barabarta për të gjithë qytetarët. Në anën tjetër, Uashingtoni e konsideron të rëndësishme praninë e KFOR-it në Kosovë dhe konfirmim vazhdimin e mbështetjes amerikane për misionin.

Deklarata e Zëvendësndihmës Sekretarit të Shtetit Daniel Lawton para Nënkomisionit për Europën të Komitetit të Punëve të Jashtme të Dhomës së Përfaqësuesve

Kryetar Self, anëtar i rangut Keating, anëtarë të nderuar të Nënkomisionit për Europën, ju falënderoj për mundësinë që të dëshmoj sot mbi politikën e Shteteve të Bashkuara në Ballkanin Perëndimor.

Ky është një rajon i rëndësishëm për interesat amerikane dhe ne e vlerësojmë vëmendjen e Kongresit, si edhe vizitat në rajon, përfshirë vizitën më të fundit të kryetarit Self në muajin maj.

Shtetet e Bashkuara synojnë një Ballkan Perëndimor të qëndrueshëm, paqësor dhe të begatë, që kontribuon në sigurinë rajonale dhe globale. Ne po zhvillojmë marrëdhënie pozitive me aktorët kryesorë në rajon për të ruajtur stabilitetin, për të zgjeruar bashkëpunimin ekonomik dhe për t’iu kundërvënë kërcënimeve që prekin drejtpërdrejt Shtetet e Bashkuara.

Vitin e kaluar, në përkujtimin e 30-vjetorit të Marrëveshjes së Dejtonit, Zëvendëssekretari Landau e bëri të qartë se epoka e ndërtimit të kombeve nga jashtë ka përfunduar. Siç u shpreh ai, “Shtetet e Bashkuara nuk po ofrojnë mjete të pakufizuara për objektiva të papërcaktuara, të pasigurta dhe jorealiste”.

Në vend të kësaj, ne po u bëjmë thirrje liderëve lokalë të gjejnë zgjidhje lokale për problemet lokale. Ne duam që udhëheqësit në të gjithë rajonin të lënë pas debatet e së kaluarës dhe të fokusohen te nismat pragmatike që i çojnë vendet e tyre përpara.

Kjo nuk do të thotë tërheqje. SHBA mbetet aktive në promovimin e rezultateve konstruktive që avancojnë interesat tona dhe ndihmojnë aktorët lokalë në gjetjen e zgjidhjeve të tyre. Ne jemi të gatshëm të punojmë me ata që duan të ecin drejt së ardhmes, por kemi pak interes për ata që minojnë stabilitetin për interesa personale ose që rikthejnë vazhdimisht ankesat e dekadave të kaluara.

Politika amerikane mbështetet mbi tre shtylla. E para është ruajtja e stabilitetit, një parakusht për të gjitha objektivat tona. E dyta është avancimi i interesave ekonomike dhe tregtare të SHBA-së përmes rritjes së udhëhequr nga sektori privat dhe krijimit të një klime që mirëpret bizneset amerikane. Ne i shohim këto dy shtylla – stabilitetin dhe prosperitetin – si elemente që forcojnë njëra-tjetrën.

Shtylla e tretë është bashkëpunimi me partnerët për t’iu kundërvënë kërcënimeve, përfshirë organizatat kriminale transnacionale që bashkëpunojnë drejtpërdrejt me kartelat e Hemisferës Perëndimore që kërcënojnë Shtetet e Bashkuara.

Ne i ndjekim këto objektiva përmes angazhimit të vazhdueshëm në nivelet më të larta dhe duke përdorur të gjitha mjetet që kemi në dispozicion. Aktorët e rajonit e dinë se SHBA disponon instrumente shtesë të miratuara nga Kongresi. Gjithashtu, presim që partnerët europianë të mbajnë një pjesë më të madhe të barrës së sigurisë në rajon.

Për aleatët tanë të NATO-s në Ballkanin Perëndimor, kjo përfshin modernizimin e forcave të armatosura dhe përbushjen e angazhimeve për shpenzimet e mbrojtjes, në funksion të vizionit tonë të përbashkët për një NATO më të balancuar dhe më rezistente.

Shtetet e Bashkuara mbeten të përkushtuara ndaj sovranitetit dhe integritetit territorial të Bosnje-Hercegovinës dhe ndaj stabilitetit të garantuar nga Marrëveshja e Dejtonit. Vitin e kaluar, diplomacia amerikane zgjidhi një krizë të zgjatur, duke ruajtur kohezionin ligjor dhe rendin kushtetues të vendit, si edhe duke siguruar tërheqjen e legjislacionit më kundër Dejtonit të miratuar nga Republika Srpska.

Ulja e tensioneve krijoi hapësirë për përparim në projektin e gazsjellësit të Interkoneksionit Jugor me Kroacinë, i cili do të diversifikojë furnizimin dhe sigurinë energjetike të Bosnjës. Projekti do të nxisë gjithashtu rritjen ekonomike dhe do të krijojë mundësi për kompanitë amerikane.

Muajin e ardhshëm qytetarët e Bosnje-Hercegovinës do të votojnë në zgjedhje dhe ne jemi të gatshëm të punojmë me udhëheqjen e re mbi interesat e përbashkëta.

Në të njëjtën mënyrë, SHBA mbetet e përkushtuar ndaj pavarësisë dhe integritetit territorial të Kosovës. Ne kemi një axhendë të gjerë bashkëpunimi me Kosovën, e cila fatkeqësisht është penguar nga zgjedhjet e përsëritura, qeveria e zgjatur në detyrë dhe vonesat në formimin e institucioneve të nevojshme për avancimin e prioritetëve tona të përbashkëta.

Ne u kemi bërë thirrje liderëve të Kosovës që ta përmbyllin këtë proces në përputhje me Kushtetutën dhe vendimet gjyqësore. Gjithashtu kemi shprehur shqetësime për mbikëqyrjen e tepruar ligjore dhe veprimet policore ndaj popullsisë serbe në Kosovë. Të gjithë qytetarët e Kosovës duhet të gëzojnë të drejta të barabarta dhe mbrojtje të ligjit nëse vendi dëshiron të ruajë stabilitetin.

Forca e NATO-s në Kosovë (KFOR) mbetet thelbësore për garantimin e një mjedisi të sigurt dhe mbështetet edhe nga kontributi i forcave amerikane.

Në Shtëpi ne na përmendim Shkretën e Bashkuar si shtet të hapur dhe të lirisë, por në të njëjtën kohë ne mbështetim shtetet demokratike. Dëshirojmë

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.